



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • ëëë.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 3640

Prishtinë, Dt. 06/10/2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	i Shkencave Matematike Natyrore
Departamenti/ Programi	i Gjeografisë
Projektpropozimi	Analizë e lëvizjes së numrit të popullsisë në komunat e Kosovës siaps regjistrimit të popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare, 2024
Kandidati	Leonita Xhekaj
Mentori	Prof. Asoc. Dr. Mimoza Dushi
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 27.11.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 5741

Vlerësimi i dorëshkrimit

Kandidatja Leonita Xhekaj studente në programin master të Gjeografisë, pas përfundimit të suksesshëm të provimeve dhe përmbushjes së obligimeve të tjera të parashikuara me rregullore, ka fituar të drejtën të punojë në temën e diplomës me titull: "Analizë e lëvizjes së numrit të popullsisë në komunat e Kosovës siaps regjistrimit të popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare, 2024".

Punimi është i strukturuar në nëntë kapituj tematikë dhe trajton me seriozitet e kujdes një temë me rëndësi të veçantë shoqërore dhe demografike. Qasja metodologjike është ndërtuar mbi metoda historike, analitike e statistikore dhe krahasuese, ndërsa të dhënat bazohen kryesisht në burime zyrtare si Agjencia e Statistikave të Kosovës, si dhe në burime të përzgjedhura të literaturës akademike. Punimi përban 78 faqe tekst dhe katër table.

Në kapitujt hyrës, kandidatja ka formuluar në mënyrë të qartë pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat, duke ndërtuar bazën teorike të hulumtimit. Ajo e ka përqëndruar analizën në lëvizjen e numrit të popullsisë në të gjitha komunat e Kosovës, sipas regjistrimeve të popullsisë. Gjithashtu ka përcaktuar qëllimet e studimit, të cilat janë: të analizojë lëvizjen e numrit të popullsisë së Kosovës në regjistrimin e vitit 2024; të shqyrtojë faktorët që kanë ndikuar në ndryshimet demografike, të vlerësojë ndikimin e këtyre faktorëve në politikat lokale që zhvillim të qëndrueshëm komunal.

Në pjesën e tretë të punimit, trajtohet çështja e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe

banesave, përfshirë definimin e koncepteve, llojin e të dhënave, organizimin e procesit të regjistrimit, formën e mbledhjes së të dhënave dhe analizën e tyre. Gjithashtu, jep të dhënat për institucionet përgjegjëse rreth organizimit, krijimit dhe funksionimit të strukturave organizative, dhe përgjegjësitë qytetare.

Më tej, në kapitullin vijues trajton aspektin historik të regjistrimeve të popullsisë në Kosovë. Analizon zhvillimet politike, administrative e territoriale në regjistrimet e periudhës kohore 1921-1981 në Kosovë. Në këtë pjesë analizon lëvizjen e numrit të popullsisë nëpër të gjitha komunat e Kosovës, me theks të veçantë në regjionet urbane dhe ndikimin e faktorëve demografikë, ekonomikë, socialë, politikë e administrativë në ndryshimin e numrit të popullsisë nëpër regjistrime. Gjithashtu, përshkruan vlerësimin e popullsisë të realizuar në 1991 si rezultat i refuzimit të shqiptarëve për pjesëmarrje, përfshirë arsyet e refuzimit dhe vlerësimin e realizuar nga Enti Federativ Statistikor Jugosllav dhe rezultatet e tij, përfshirë edhe shtrirjen e numrit të popullsisë nëpër komuna. Në të njëjtën kapitull trajtohen edhe rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, të shtrirë sipas komunave, popullsisë urbane e rurale dhe gjinisë. Në këtë pjesë kandidatja përcakton madhësinë e qyteteve në varësi të numrit të popullsisë, që e përdor për analizat e metjme pastaj. Klasifikimin e qyteteve e bën sipas modelit: qytetet të mëdha që kanë mbi 100 mijë banorë; të mesme 20-100 mijë banorë; të vogla 5-20 mijë banorë dhe qytetëzat me më pak se dy mijë banotë.

Në kapitullin e pestë kandidatja i kthehet edhe një herë çështjeve organizative të regjistrimit, me theks në risitë në çështje metodologjike e teknike të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë në vitin 2024. Këtu përshkruan gjithë procesin dhe përgatitjet që e kanë karakterizuar këtë regjistrim përfshirë definimin e koncepteve, institucioneve të përfshira dhe strukturat organizative, ligjin e regjistrimit, konceptcionin e regjistrimit dhe mundësinë e regjistrimit të popullsisë së Kosovës që jeton jashtë kufinjëve të saj, si dhe aplikimin e metodës elektronike CAPI (Computer-Assisted Personal Interviewing) për mbledhjen e të dhënave në terren.

Në kapitullin e gjashtë, që njëherit është edhe pjesa qendrore e këtij studimi, kandidatja ka analizuar rezultatet e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë në vitin 2024. Ka përshkruar numrin e popullsisë nëpër secilën komunë, të ndara sipas vendbanimit urban-rural dhe gjinisë, duke i klasifikuar sipas të njëjtave kriteret të klasifikimit. Gjithashtu, ka bërë krahasimin e të dhënave me rezultatet e regjistrimit të vitit 2011 për të analizuar rritjen, përkatësisht zvogëlimin e numrit të popullsisë nëpër secilën komunë veç e veç.

Në kapitullin e shtatë, që në fakt është vazhdimësi e analizës së të dhënave të regjistrimit të vitit 2024, kandidatja përshkruan shkaktarët e ndryshimit të numrit të popullsisë nëpër komunat e Kosovës, duke u fokusuar te migrimet e jashtme dhe të brendshme dhe ndryshimet në shkallën e lindshmërisë. Përtej kësaj, kandidatja në kapitullin vijues, përcakton edhe faktorët limitues që kanë ndikuar në shkallën e besueshmërisë, saktësisë dhe krahasueshmërisë së të dhënave.

Në përfundim, kandidatja përmbledh të gjitha gjetjet kryesore të punimit. Jep një pasqyrë të plotë të lëvizjës së numrit të popullsisë, të ndarë sipas moshës, gjinisë dhe tipit të vendbanimit, për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në vitin 2024 dhe krahasueshmërinë me vitin 2021. Në këtë pjesë kandidatja mbron hipotezat e ngritura në fillim se tkurrja e popullsisë është e evidente, rritja demografike lidhet me zhvillimin ekonomik në komunat urbane, dhe se migrimi i jashtëm ka qenë një faktor kryesor i rënies së popullsisë në disa vendbanimet rurale. Gjithashtu, thekson se ndryshimet demografike janë të theksuara, ato ndodhin më shumë në disa komuna sesa në të tjera, dhe se faktorët influencues kryesorë lidhen me migrimin, urbanizimin dhe ndryshimet socio-ekonomike.

Punimi i diplomës së Leonita Xhekaj është i ndërtuar në mënyrë të qëndrueshme dhe mbështetet në të dhëna relevante e literaturë shkencore. Kandidatja dëshmon aftësi të qarta për analizë teorike dhe empirike, shprehje akademike të saktë dhe qasje serioze kërkimore. Struktura e punimit është e qartë,

përmbajtja e qëndrueshme dhe përfundimet janë në përputhje me qëllimin e deklaruar.


Në mbështetje të këtij vlerësimi, Komisioni për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së diplomës master te titull “Analizë e lëvizjes së numrit të popullsisë në komunat e Kosovës siaps regjistrimit të popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare, 2024” të kandidatës Leonita Xhekaj, ka marrë parasyh të gjitha vështirësitë që e përcjellin punën kërkimore e empirike dhe paraqet këtë


P R O P O Z I M


Departamentit të Gjeografisë dhe të instancave përkatëse të Fakultetit Shkencave Matematike-Natyrore që tema e masterit “Analizë e lëvizjes së numrit të popullsisë në komunat e Kosovës siaps regjistrimit të popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare, 2024” e kandidatës Leonita Xhekaj, i plotëson kushtet profesionalo-shkencore dhe ligjore që të procedohet për mbrojtje publike dhe kandidatja të fitojë titullin e masterit të shkencave gjeografike.

Prishtinë, 06.10.2025

Komisioni:


Prof. Dr. Arsim Ejupi, kryetar


Prof. Asoc. Dr. Mimoza Dushi,
anëtare


Prof. Ass. Dr. Fitim Humolli, anëtar